

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Nëse sëmureni

Jeni të mirëpritur të kontaktoni Bashkinë e Rrethit Kronoberg nëse keni pyetje nëse jeni sëmurur ose plagosur.

Telefononi 112 në rast urgjence

Telefononi SOS Alarm në numrin 112 në rast sëmundjesh apo plagosjesh vdekjeprurëse. SOS Alarm punon 24 orë në ditë. Ata mund t'ju këshillojnë ndërsa ju prisni që të mbërrijë ambulanca.

Telefononi 1177 për këshilla mbi kujdesin për shëndetin

Ju mund të telefononi qendrën e urgjence mjekësore në çdo kohë. Ju mund të flisni me dikë që mund t'ju përgjigjet të gjitha pyetjeve tuaja. Mund të mësoni nëse mund të bëni diçka që të ndihmoni veten ose nëse duhet të kontaktoni një infermiere, doktor ose pavidonin e urgjencave në spital.

Nëse sëmureni gjatë ditës

Qendra e kujdesit shëndetësor parësor ka personel i cili di se si të trajtojë shumicën e sëmundjeve. Këshillimi i duhur në disa raste është i mjaftueshëm por në raste të tjera mund t'ju duhet një vizitë tek doktori.

Doktori juaj në qendrën e kujdesit të shëndetit parësor mund të organizojë kujdes të specializuar në një spital nëse kërkohet një gjë e tillë.

Nëse sëmureni në mbrëmje, gjatë natës ose gjatë fundjavës

Telefononi qendrën mjekësore të urgjencave në rast urgjence në mbrëmje, gjatë natës ose gjatë fundjavës kur qendra juaj e kujdesit shëndetësor parësor është mbyllur. Telefononi gjithnjë qendrën mjekësore të urgjencave përpara vizitave.

Ljungby – orari i punës: E hënë – E premte 17.00 – 21.00, E shtunë – E diel 08.00 – 21.00 tel: 0372-58 51 00

Växjö- orari i punës: E hënë – E premte 17.00 – 21.00, E shtunë – E diel 08.00 – 21.00 tel: 0470-58 78 00

Vetë-kujdesi

Cilësia e jetës varet nëse ju jeni mirë me shëndet dhe ndiheni mirë. Ne duhet të trajtojmë mendimet dhe ndjenjat tona në mënyrë që të ndihemi mirë rreth vetes dhe të kujdesemi për trupin tonë. Marrëdhëniet tona me individët e tjerë janë të rëndësishme sikurse është mundësia jonë për të marrë vendime të drejta të cilat ndikojnë mbi jetën tonë. Në fakt kjo mund të jetë rreth mundësisë tonë për të përjetuar përvoja në jetën tonë pavarësisht situatës tonë individuale. Ju mund të merrni më shumë informacion rreth jetës së mirë në faqen e internetit të Bashkisë së Rrethit.

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Libri i vetë-kujdesit

Udhëzuesi për vetë-kujdes përmban informacion dhe këshilla të dobishme rreth asaj se çfarë mund të bëni ju për të minimizuar ose kuruar gjërat e thjeshta. Udhëzuesi ju ndihmon edhe të vendosni nëse duhet të kontaktoni shërbimet e kujdesit shëndetësor. Mund të merrni një kopje falas në recepsionet e spitalit dhe në klinikat e kujdesit shëndetësor të Bashkisë së Rrethit. Mund të porositni edhe një kopje nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë së Rrethit. Udhëzimi për vetë-kujdesie në format CD mund të porositet duke telefonuar: 0470-58 85 56.

www.1177.se

Në faqen e internetit 1177.se/Kronoberg mund të lexoni më shumë rreth sëmundjeve, ekzaminimeve dhe vetë-kujdesit. Këtu mund të gjeni edhe informacion për pacientin, adresat e kontaktit, shërbimet në internet dhe lajmet rreth Bashkisë së Rrethit Kronoberg.